



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-280/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Helion 300 SL** i prodhuesit “**Ciech Sarzyna S.A**”, Poloni nga përfaqësuesi i saj “**Agrounion**” SH.P.K, Fushë Kosovë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Clopyralid.....300g/l

**4. PËRDORIMI:**

**Helion 300 SL** është herbicid selektiv sistemik për kontrollin e një game të gjerë të barërave të këqija gjethegjera në drithëra (grurë, elb, tërshërë, tritikall) misër dhe qepë.

**Tek drithërat:** Kontrolli i disa barërave të këqija gjethegjera, si: *Cirsium arvense*, *Matricaria chamomilla*, në përqendrim 0,3-0,5L/ha, vetëm një herë pas mbirjes.

**Tek kultura e mistrit:** Kontrolli i disa barërave të këqija gjethegjera, si: *Cirsium arvense*, në përqendrim 0.3-0.5L/ha, një herë kur misri është në fazën e 2-4 gjetheve (BBCH 12-14).

**Tek qepa:** Kontrolli i disa barërave të këqija gjethegjera, si: Cirsium arvense në përqendrim 0,6-1L/ha, një herë kur qepët arrijnë lartësinë 10-15cm. Sasia e përdorur e ujit: 200-400L

#### **5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:**

50ml, 100ml, 500ml, 1L, 5L, 20L, 25L, 200L, 500L, 1000L

#### **6. VËREJTJE:**

Mund të përzihet me produkte si MCPA amine 2.4D amine, fluroxypr. Përdoreni këtë produkt në atë mënyrë që është në përputhje me masat higjienike dhe teknike të mbrojtjes. Mos lejoni të bie në kontakt me lëkurën dhe mukozën. Rekomandohet të vishni veshje mbrojtëse, dorëza dhe syze për mbrojtjen e syve/fytyrës. Gjatë punës mos hani apo pini duhan. Pas punës lani me ujë dhe sapun duart, fytyrën dhe nëse është e nevojshme edhe pjesët e tjera të trupit. Gjatë trajtimit parandaloni kontaminimin e ujit (rrjedha ujore, puse, liqene, burime uji, kanalizime) duke trajtuar të paktën 20m larg tyre. Nëse produkti hyn në kanale kanalizimesh ose në rrjedha ujore, informoni autoritetet përkatëse.

#### **7. KARENCA:**

**Ne drithëra dhe misër,** mos korrni për 10 jave pas aplikimit

**Ne qepe,** mos i korrni për 3-4 jave pas aplikimit

#### **8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:**



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)

**9. VENDI I SHITJËS:** Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**10.** Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

**11.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:*

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.

**Faton Peci**  
**Ministër**